



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUALE**

**PA1 Nr.08-220**

**08.08.2024**

**Shkup**

Në pajtim me nenin 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4, dhe nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.42/20, 77/21, 154/23 dhe 55/24), në pajtim me nenin, 10 paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i konsoliduar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, Vendimin PA1 nr.08-210 datë 30.07.2024 për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, PA1 nr.08-437 datë 15.8.2016 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3384/5 datë 07.08.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 32-të mbajtur më 7.8.2024 miratoi:

**Aktvendim**  
**për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve**

1. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve.
2. Ky aktvendim botohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në ueb-faqen e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

**A r s y e t i m**

Në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 4 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), leja për transmetim televiziv ose radio ndalon të vlejë sipas fuqisë ligjore, me heqjen e lejes nga ana e Agjencisë. Në pajtim me paragrafin (2) sipas nenit të cituar të ligjit, Agjencia do të fshijë radiodifuzerin nga regjistri i transmetuesve me përfundimin e vlefshmërisë së lejes në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 31-të mbajtur më 29.7.2024, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-3290/2 datë 29.7.2024, miratoi Vendim PA1 nr.08-210 datë 30.07.2024, me të cilin i hiqet leja Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, PA1 nr.08-437 datë 15.8.2016, për shkak se poseduesi i lejes nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio

në afatin e parashikuar ligjor prej - 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës me nr.2024-100-0151 datë 10.6.2024 (nr ynë.ark.05-2680/1 datë 10.06.2024).

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lart, dhe në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe neni 85 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar), Vendimin PA1 nr.08-210 datë 30.07.2024, për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, PA1 nr.08-437 datë 15.8.2016 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3384/5 datë 07.8.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 32-të mbajtur më 07.8.2024, miratoi aktvendim si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.